


Kiko DHE Vetja e Shumëfishuesi




The background features a grid of stars in various colors (white, light blue, light orange) arranged in a pattern that resembles the European Union flag. A vertical line divides the background into two halves: the left half has a pink-to-purple gradient, and the right half has a blue-to-pink gradient.

Kiko DHE Vetja
e Shumëfishuesi



Këtu janë Kiko dhe Pipa. Pipa kujdeset për Kikon, i cili mëson shumë duke parë Pipan e zgjuar. Ata duhen me një-tjetrin dhe kalojnë shumë kohë duke luajtur dhe diskutuar.



Dhe ky është... bilbili magjik!
Sa herë që Kiko i fryn bilbilit, Pipa shfaqet si me magji. Pipa gjithmonë është aty për Kikon!

FLLUI FLLUI bën bilbili magjik.



“Çfarë është ai, pyet Kiko”.

“Është ekran. Ekranet janë dritare magjike për të parë një botë tjetër”, u përgjigj Pipa.

“Më trego më shumë për atë botë!”

“Është një vend ku mund të mësosh shumë gjëra dhe të argëtohesh me miq nga gjithandej planetit”, shpjegoi Pipa.

“Por mund të jetë rrezik, Kiko. Duhet të jesh shumë i matur”.

“Jam super i matur!” tha Kiko.

“Mirë pra, po t’i tregoj rregullat e arta lidhur me ekranet, dëgjo me vëmendje”.





NJË

Pyet para se ta përdorësh ekranin.

DY


Mendo para se të bësh diçka.



Dhe **TRE ...**
kërko ndihmë nëse të duhet! shtoi Kiko.



“Ashtu pra, Kiko!
Afër ekranit,
gjithmonë mbaje
bilbilin magjik afër.
Dhe nëse të duhet
ndihmë...”



Hej Kiko! Eja fytyra
qeshakare bashkë! Bëj
fyturë të qeshur dhe unë
po bëj foto!



Hej, nuk mund
t'i kap të gjitha!!

Shfaqet vetja e Shumëfishuesi dhe fillon t'i hajë fotografitë. Vetja e Shumëfishuesi ka fuqi të veçantë. Kur ai i ha fotot, krijohen mijëra prej tyre!

Ndalo!
Janë të miat!

“KRRAU KRRAU! Janë të miat tani!” qeshi vetja e Shumëfishuesi duke u larguar fluturimthi.

Fllui! Fllui! Kiko i fryn bilbilit.

Pipa erdhi për ndihmë!

Pipa! Më ndihmo t'i kap fotografitëe mia!

Svif, svif! Pipa dhe Kiko i mbledhin të gjitha fotot. Fiks në kohë! vetja e Shumëfishuesi largohet fluturimthi

“Çfarë aventure! Të shkojmë në shtëpi tani Kiko!”

Është koha për banjë! Pllaq
plluq! Kikos i pëlqejnë
peshqit fluturues.



Hapet dera dhe futet Eki.

“Hej Kiko! Dukesh lezetshëm në
fluska! A mund ta bëj një fotografi?”
pyeti Eki.

“JO!” bërtiti Kiko duke fryrë fluskat
drejt ekranit.

“Mirë, mirë Kiko” tha Eki duke u
larguar fluturimthi.



Çfarë dite! Kiko ndiheti lodhur.

“Koha e gjumit Kiko!” thotë Pipa.

“Në rregul”, tha Kiko i përgjumur.



“Kiko, a mund të të bëj një fotografi për albumin tonë?” pyet Pipa.

Jo sot Pipa,
jam i lodhur.



Mirë Kiko. Është në
rregull të thuash
jo.



A ju kujtohen mësimet që Kiko i mësoi për bërjen e fotografive?



NJË


Së pari gjithmonë kërko leje.

DY

Fotografia ime është e imja!

“Të gjithë duhet të kërkojnë leje para se të më bëjnë një fotografi”, thotë Kiko.

“...dhe askush, KURRË nuk duhet të bëj foton tënde nëse je i zhveshur”, shton Pipa.



TRE

Kam të drejtë të them jo!

“Dhe nëse nuk di çfarë të bësh...” thotë Pipa.
FLLUI FLLUI!

“Shumë mirë Kiko. Ishte një ditë plot me aventura! Tani po i bie bilbilit me këngën tënde të dashur dhe së shpejti do të flesh”



Dhe ndërkohë që Pipa i bie bilbilit, Kiko fillon të ëndërrojë për bonbonet që po rriteshin gjithkund.



Botimi francez:
Kiko et les Moipartouts

Të gjitha kërkesat në lidhje me riprodhimin ose përkthimin e të gjithë ose ndonjë pjese të këtij materiali duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int). Çdo korrespondencë tjetër në lidhje me këtë material duhet t'i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme për Demokraci.

© Këshilli i Evropës, nëntor 2020
Ilustrimi dhe faqosja: AFP-Services

Ky libër që lexohet para gjumit duhet t'u shpjegojë fëmijëve të moshës 4 - 7 vjeç disa rregulla themelore për përdorimin e ekraneve dhe rëndësinë e mbrojtjes së imazhit dhe privatësisë së tyre. Nëse doni të dini më shumë rreth kësaj teme, shkoni në www.underwearrule.net

Këshilli i Evropës me mirënjohje e pranon përkrahjen financiare të dhënë për këtë program nga Fondi 'End Violence'. Fondi 'End Violence' u jep përkrahje financiare programeve që japin zgjidhje praktike, inovative për t'i mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi dhe abuzimi online.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i krijuar për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr implementimin e Konventës në shtetet anëtare.

ALB